

PKR.nr.429/15

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA,** kryetarja e trupit gjykues, si gjyqtare e vetme gjykuese Suzana Çerkini, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit H. H. nga fshati Ll. e P. Komuna P., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.588/2013 të datës 30.07.2015, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 02.12.2016, me praninë e Prokurorit të shtetit Hivzi Bajraktari dhe të të pandehurit H. H., të njëjtën ditë, mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri H.H.**, i biri i S. dhe nënës M., e vajzërisë B., i lindur me *data e lindjes...* në fshatin Ll. e P. Komuna P., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, punon teknik në laborator të “TCB K. B”, i martuar babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me letërnjoftim RKS me nr. personal *numër personal...*,

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse**, me datë 15.06.2013, rreth orës 22:00, në fshatin Ll. e P. Komuna P., nga ana e policisë, në shtëpinë e tij brenda në oborr , gjatë një ahengu i pandehuri H. H. ka gjuajtur në ajër në shenjë gëzimi, dhe gjatë kontrollimit nga ana e policisë, është gjetur dhe konfiskuar një pistoletë e tipit “Pjetto Beretta”, model 70 e kalibrit 7.65x17 mm, me nr. serik L-66382 prodhim Çekosllovak, të cilën e ka poseduar në shkelje me ligjin e zbatueshëm për armë,

- me çka ka kryer veprë penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 21, 41,42, 49, 50, 51, 62 par.2.6, 69, 73, 74 të KPRK dhe neneve 248 par.4, 365, 366 të KPP, i shqipton,

## **DËNIM ME KUSHT**

Në kohëzgjatje prej **1 (një) viti** i cili nuk do të ekzekutohet, nëse brenda afatit prej **2 (dy) vitesh** nuk do të kryejë veprë të re penale, dhe

## **DËNIM PLOTËSUES**

Konfiskohen: një pistoletë e tipit “Pjetro Bereta”, model 70, me numër serik L66382, si dhe një karikator i zbrazët, të precizuara në procesverbalin e dëshmisë Nr.2013-AF-0864 të datës 15.06.2013,

I pandehuri obligohet t’i paguajë shpenzimet e procedurës penale për veprën penale për të cilën është shapllur fajtor, për aq sa do të bëhen sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor do të paguajë shumën prej 30 € (tridhjetë euro), në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me Aktakuzën PP/I.nr.588/2013 të datës 30.07.2015, ka akuzuar të pandehurin H. H., për veprë penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK dhe, njëherësh ka propozuar gjykatës që, pas administrimit të provave të propozuara në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t’a shpall fajtor dhe t’a dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti shqyrtim fillestar, në të cilin Prokurori i shtetit fillimisht bëri precizimin e dispozitivit të aktakuzës, nga vepra penale Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par. 1 të KPRK, në veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK. I pandehuri H. H. duke u vënë në dijeni të plotë për pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë, me vullnet dhe vetëdije të plotë, e pranoi në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, për çka theksoi se është e vërtetë se me pistoletë ka gjuajtur në ajër, e pastaj të njëjtën policia ia ka konfiskuar, i njëjti shton se kjo ka qenë me rastin e martesës së vëllaut të tij, ndihet i penduar, kjo ka qenë hera e parë të ketë rënë ndesh me ligjin dhe premtoi se edhe në të ardhmen nuk do të përsëris veprë të tilla apo të ngjashme.

Pas pranimit të fajësisë nga i pandehuri, prokurori i shtetit theksoi se pajtohet me pranimin e fajësisë, i cili pranim është konform dispozitave ligjore të nenit 248 të KPP, në përputhje me provat materiale që gjenden në aktakuzë, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë, për veprën penale të përshkruar si në aktakuzë.

Pas mendimit të prokurorit të shtetit, gjykata, duke vlerësuar se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është dhënë në përputhje me dispozitat ligjore nga neni 248 par.1 të KPP, se i njëjti në mënyrë

bindëse dhe vullnetarisht ka pranuar fajësinë, duke qenë në dijeni për natyrën, pasojat e pranimin të fajësisë dhe në përputhje të plotë me faktet e provat nga shkresat e lëndës, e aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri H. H., për veprën penale e cila u vihet në barrë.

Andaj, meqë në veprimin e të pandehurit formësohen të gjitha elementet e veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.1 të KPRK, pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Gjatë matjes dhe përcaktimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit, si rrethanat lehtësuese: pranimin e fajësisë, shprehjen e keqardhjes për rastin e ndodhur, kërkim faljen në gjykatë për gabimin e bërë, faktin se për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, premtimin e dhënë se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla, ndërsa rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit i përcaktoi dënim me burgim te cilin ia kushtëzoi për periudhe të caktuar verifikuese, te precizuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të të pandehurit, se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe se të njëjti, në të ardhmen nuk do të përsëris vepër tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimi për konfiskimin e armës dhe gjësendeve të tjera, të mbajtura, në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 69 lidhur me nenin 374 par.3 të KPRK.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/ DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.429/15, me datë 02.12.2016**

**Sekretarja juridike**

**Kryetarja e trupit gjykues-Gjyqtarja**

**Ardita Azemi**

**Suzana Çerkini**

---

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.